33	17.09.2026	Kërkojmë a është pajisur me leje ndërtimi…..	22.09.2026	Në përgjigje të shkresës Suaj…….Ju sqarojmë se: AZHT e cila aktualisht kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të KKTU-së,është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.725,datë 02.09.2015 'Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT',i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar,kjo Agjenci ka kompetencë pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU,me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Për sa më sipër,referuar objektit të kërkesës Suaj,ju bëjmë me dije se nga verifikimi në databazën e institucionit tonë,sipas dokumentacionit bashkëlidhur skkresës suaj,në pasurinë.....nuk rezultoi të ketë aplikim pleje zhvillimi/ndërtimi,e për rrjedhojë nuk kas as vendimmarrje nga anan e KKTU në favor të..... Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,	E plotë	Nuk ka

34	18.09.2026	Kërkesë për verifikimin e lejes së ndërtimit të dhënë mbi një pasuri për të cilën disponoj vendim gjyqësor për njohjen e faktit të pronësisë	28.09.2026	Në përgjigie të shkresës Suaj ,..... ju bëjmë me dije se: AZHT kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të KKTU dhe në përputhje me VKM-në Nr. 725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimil dhe funksionimit AZHT e ndryshuar, e cila ka kompetencën për të pranuar, përgatitur dhe administruar dokumentacionin tekniko-ligior shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKT, ndërkohë autoriteti për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe ndërtimi, apo ndryshimet e tyre, është vetëm KKTU. ..... Në lidhje me këtë aplikim KKTU..... ka miratuar me kusht Lejen e Ndënimit për objektin..... në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligiore në zbatim të tij, vendimmarrje e cila është zbardhur ..... Vendimmarrjen e sipërcituar mund t'a aksesoni në faqen zyrtare të AZHT-së www,azht.gov.al në rubriken "Vendime KKT". Në vijim ju bëjmë me dije se, dokumentacioni që administrohet nga ana e AZHT-së për çdo aplikim që paraqitet pranë tij në sistemin e-leje, vjen në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (e ndryshuar), ku parashikohet në mënyrë të detajuar i giithë dokumentacioni tekniko-ligior që duhet të paraqesin aplikuesit për miratimin e lejes së ndërtimit, në Nenin 15 "Dokumetacioni për pajisje me leje ndërtimi", pika (l) gërma (b) po të VKM-së 408/2015, përcaktohet se një nga dokumentat që nevojitet për pajisjen me leje ndërtimi është dhe "Dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronave që marrin pjesë në zhvillim, duke përfshirë edhe vërtetimet e pronësisë për zonat kadastrale të cilat nuk i janë nënshtruar regiistrimit fillestar, si dhe marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta" të cilat janë dokumente që ofrohen nga ASHK apo Drejtoritë Vendore të saj. Gjithashtu, giatë shqyrtimit të aplikimeve për leje zhvillimi/ndërtimi, AZHT nuk kryen verifikimin e origjinës së pronës, mënyrës së regiistrimit të saj, bazuar në Nenin 4 pragrafi 2 VKM-së 408/2015 *" ...Autoriteti i zhvillimit nuk mund të kërkoië vërtetime nga personi i interesuar lidhur me vërtetësinë apo autenticitetin e këtvre dokumenteve apo të dhënave"* , por konsiderohen të rregullta dhe konform legiislacionit në fuqi, dokumentacioni i pronësisë që disponohet nga ASHK, apo Drejtoritë Vendore të saj, të cilat janë autoriteti kompetent për Iëshimin e tyre. ..... Sa më sipër, në lidhje me pretendimet tuaja mbi pronësinë, ju orientojmë t'i drejtoheni ASHK për sa i përket vërtetësisë së dokumentacionit të pronësisë,origjinës apo mënyrës së regjistrimit të pasurisë objekt i kërkesës suaj.	E plotë	Nuk ka

35	18.09.2026	Kërkesë	01.10.2026	Në përgjigje të kërkesës Suaj…ju sqarojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë AZHT, rezulton se pasuria për të cilën i referohet kontrata e sipërmarrjes nuk përben pasuri objekt zhvillimi në kuader të procedures së lejes së zhvillimit/ndërtimit të administruar nga AZHT. Për rrjedhojë, sikurse ju kemi sqaruar dhe në korrespondencat e mëparshme, kontrata e sipërmarrjes e lidhur për këtë pasuri nuk është kërkuar, nuk është administruar dhe nuk përbën pjesë të dokumentacionit të paraqitur pranë AZHT-së në kuadër të procedurës administrative përkatëse. ..... AZHT, në ushtrim të kompetencave saj, mund të përcjellë vetëm dokumentacionin që është administruar në kuadër të procedurave konkrete zhvillimit dhe që lidhet me objektin e këtyre procedurave, ndërsa nuk mund të përcjellë apo të marrë përsipër regjistrimin e akteve juridike që nuk janë pjesë e procedurës administruar prej saj. Për çdo të drejte që rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes, përfshirë regjistrimin e saj dhe përcaktimin e pjesëve takuese, lutemi t'i drejtohen organit kompetent të kadastrës ose ti ndiqni rrugët e tjera juridike të parashikuara nga legiislacioni në fuqi. ..... Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm,	E plotë	Nuk ka
36	21.09.2026	Njoftim zyrtar refuzim firme për leje ndërtimi të për objektin….....	30.09.2026	Në përgjigje të kërkesave tuaja….Ju informojmë se: AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së, është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT", e ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agienci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionin që shqyrtohet në mbledhjet e KKT, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Për sa më sipër,ju bëjmë me dije se nga verifikimi....në databazën e institucionit tonë, për pasuritë.....,nuk rezultoi të ketë aplikim për leje zhvillimi/ndërtimi nga shoqëria.....,e për rrjedhojë nuk ka as vendimmarrje nga KKTU. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

37	23.09.2026	Për verifikimin, pezullimin dhe mosmiratimin e projektit ndërtimor…..	01.10.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj…....., ju informojmë se: …. Sqarojmë se, KKTU është organ kolegjial, që funksionon pranë Këshillit tv Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri. Vendimmarrja e sipërcituar është ndërmarrë pas një vlerësimi të përbashkët të anëtarëve të këshillit në zbatim të Ligiin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Për sa i përket pretendimit té ngritur në ankesén tuaj, lidhur me lartësinë e objektit dhe raportin e tij me parametrat e parashikuar në dokumentin e planifikimit, sqarojmë se, legjislacioni në fuqi parashikon një regiim te posaçëm për përcaktimin e kushteve të zhvillimit për rastet që janë kompetencë e KKTU-së. Konkretisht Ligii nr. 107/2014, i ndryshuar, përcakton se KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj. Në lidhje me vendimmarrjen e sipërcituar si dhe referuar Ligiit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në pikën 3 të Nenit 28 "Përgiegiésite e KKTU", përcaktohet se: "*KKTU-ja vendos miratimin e rrvgullreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj"* . Në vijim, referuar pikës 15 të Nenit 3 të Ligiit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" e ndryshuar, citohet se: "*15. Kushtet zhvillimore" janë kushtet e përcaktuara nga dokumenti i planifikimit në fuqi ose, në rastet e investimeve strategjike dhe rastet përjashtimore, të përcaktuara nga autoriteti përgiegjës i planifikimit dhe zhvillimit me rregullre të veçantë."* Po ashtu në pikën 1 të Nenit 37 "Kushtet e zhvillimit" të Ligiit Nr. 107/2014 "'Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" e ndryshuar, përcaktohet se: *"1. Zhvillimi lejohet vetëm në kushtet e përcaktuara nga dokumentet e planifikimit apo në rregulloret e veçanta të miratuara nga KKTU-ja,për rastet në kompetencë të tij."* .... Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se, vendimin, planin e vendosjes së ndërtimit dhe dokumentin e rregullores së veçantë,i gjeni në faqen-zyrtar të AZHT http:wvw.azht.gov.al, në seksionin "Vendime KKT".	E plotë	Nuk ka
38	23.09.2026	*Shënim* : kërkesë pa objekt	06.10.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj…ju informojmë se: AZHT e cila aktualisht kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të KKTU-së,është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.725,datë 02.09.2015 'Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT',i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar,kjo Agjenci ka kompetencë pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU,me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. ..... Në vijim,në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,KKTU.....ka vendosur refuzimin e lejes së zhjvillimit për objektin.....Vendimmarrjen e sipërcituar mund t'a aksesoni në faqen zyrtare të AZHT-së www.azht.gov.al në rubrikën 'Vendime KKTU'. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

39	23.09.2026	Kundërshtim formal dhe kërkesë urgjente-verifikim i projektit, kufijve dhe aksesit në…..	28.09.2026	Pranë AZHT është depozituar nëpërmjet postës elektronike kërkesa ....., Ju informojmë se: Nga verifikimi .., referuar pozicionit hartografik të vendosur në dispozicion nga ju, rezulton se, pranë AZHT është depozituar nëpërmjet sistemit e-leje, aplikimi....., aplikim i cili është ende në proces shqyrtimi të dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e institucionit tonë, dhe për të cilin nuk ka ende një vendimmarrje nga ana e KKTU. Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se, gjurma e projekt-propozimit të sipërcituar prek vetëm pasurinë ...në pronësi të shoqërisë ... e cila njëkohësisht rezulton të jetë shoqëria zhvilluese e këtij projekti. Ndërkohë, referuar projektit të propozuar pranë AZHT-së, akesi i propozuar rezulton të kryhet nëpërmjet rrugës ekzistuese, k..... Në vijim, theksojmë se, AZHT, e cila aktualisht kryen funksionet e Sekretariat Teknik të KKTU-së, është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionin që shqyrtohet në mbledhjet e KKT, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Gjithashtu, për sa i përket dokumentacionit të kërkuar, referuar Ligj Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku në Nenin 3 citohet se: "Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji", si rrjedhojë dokumentacioni që ju kërkoni nuk mund t'ju vendoset në dispozicion. Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin, mbetemi në dispozicion për cdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

40	24.09.2026	Kërkesë për informacion: Procedura dhe dokumentacioni për lejen e një Beach Bar-i në…..	25.09.2026	Në përgjigje të kërkesës Tuaj,përcjellë elektronikisht, në të cilën këkoni informacion mbi procedurën për strukturë shërbimi, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Në mbështetje të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM-së Nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, VKM-së Nr.725, datë 02.09.2015, "Për miratimin e organizimit dhe funksionimit të AZHT", i ndryshuar, VKM-së Nr.649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar, dhe Vendimit të KKT Nr.23, datë 28.02.2020 "Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve, brenda Zonës së Brezit Bregdetar" i ndryshuar, miratimi i Lejeve të Ndërtimit për "Struktura shërbimi në stacionet e plazhit" është kompentencë e KKTU. Në përgjigje të pyetjes Suaj të parë, dokumentacioni teknik dhe ligjor që duhet të ngarkohet në sistemin e-leje është:..... Në përgjigje të pyetjes Suaj të dytë, lloji i lejes që duhet aplikuar në sistemin e-Leje/e-Albania është "Leje për strukturë shërbimi në stacionet e plazhit për KKT". Në përgjigje të pyetjes Suaj të tretë, neni 11 i VKM 649 datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" , i ndryshuar, përcakton kriteret e përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit. Në përgjigje të pyetjes Suaj të katërt, neni 7 i VKM 649 datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar, përcakton kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.	E plotë	Nuk ka
41	24.09.2026	Kërkesë për ndalimin e menjëhershëm të punimeve të kundraligjshme të….....			Në proces	Nuk ka
42	24.09.2026	Informacion zyrtar lidhur me ekzistencën e çdo aplikimi, procedure administrative apo kërkese të paraqitur nga…..			Në proces	Nuk ka

43	25.09.2026	Kërkesë për ndërhyrje institucionsle dhe verifikim të veprimtarisë së….....	05.10.2026	Në përgjigje të shkresave…....ju bëjmë me dije se: Mbështetur në ligiin Nr- 8402, datë 10/09/1998, për "Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi/ (i ndryshuar) si dhe sipas ndryshimeve ligjore të tetorit vitil 2025 me aktet normative Nr. 7, 8 dhe 9, V KM 448 date 31.07.2025 " Pér miratimin e rregullores sé zbatimit te punimeve te ndërtimit dhe të rregullave të kantierit", si dhe ndryshimeve në V KM Nr. 408 datë 03.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit. Për sa më sipër ju informojmë se AZHT zotëron kompetenca ligiore mbi inspektimin dhe mbikëqyrjen e punimeve vetëm për lejet e miratuara nga KKTU. Për sa i përket Lejes së Ndërtimit ....., ju lutemi ti drejtoheni Institucioneve Kompetente përgjegjëse për inspektime dhe kontrolle për objektin me qëllim evaluimin e giendjes godinës. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
44	27.09.2026	Ankesë dhe kërkesë për inspektim urgjent të punimeve të ndërtimit nga…...	28.09.2026	AZHT kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të KKTU dhe në përputhje me VKM-në Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT”, i ndryshuar, si dhe ka kompetencë për të pranuar, përgatitur dhe administruar dokumentacionin tekniko-ligjor që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU. Në vijim ju sqarojmë se, në Nenin 27 “Autoritetet përgjegjëse”, të Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se “Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë: 1. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit 2. Kryetari i Bashkisë. Sa më sipër, ju bëjmë me dije se mbështetur në legjislacionin mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit, këto dy autoritete (KKT dhe Kryetari i Bashkisë), nuk janë në pozita varësie me njëri-tjetrin pra, KKTU nuk është organ epror i Kryetarit të Bashkisë dhe si rjedhojë AZHT në cilësinë e Sekretariatit Teknik nuk mund t'ju diktojë vullnetin e saj Bashkive në drejtim të interpretimit apo zbatimit të kuadrit ligjor Në këto kushte, për marrjen e informacionit lidhur me aplikimin tuaj, lutemi t'i drejtoheni Bashkisë ...., si institucioni përgjegjës për zhvillimet në territor nën juridiksionin e kësaj bashkie.	E plotë	Nuk ka
45	28.09.2026	Leje neni 6	29.09.2026	Në lidhje me kërkesën tuaj, përcjellë elektronikisht, lutemi referojuni bazës ligjore bashkëlidhur ku gjendet informacioni i plotë dhe i saktë ligjor për aplikim për leje zhvillimi dhe ndërtimi, etj.. Në këtë dokument mund të informoheni mbi dokumentat e nevojshëm për aplikim, afatet e procesit nga momenti i aplikimit deri në finalizimin e tij, palët e përfshira në proces (zhvilluesi,projektuesë të licencuar dhe autoritetet vendimmarrëse) si dhe procesin e hartimit të dokumentacionit të kërkuar për aplikim në portalin elektronik të vetëm qeveritar "e-albania", në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit "E-Leje". Gjithashtu ju informojmë se për informacion dhe sqarim më të saktë, bashkë me dokumentat që zotëroni, mund të paraqiteni pranë sporteleve të informacionit të bashkisë përkatëse.	E plotë	Nuk ka

46	29.09.2026	Kërkesë për informacion në lidhje sa vendosur për…..	29.09.2026	Në lidhje me kërkesën Tuaj, lutemi të na përcillni kërkesën sipas format kërkesës, të cilin e gjeni në faqen zyrtare të AZHT: www.azht.gov.al, në rubrikën "Programi i Transparencës", në seksionin "E drejta për t'u informauar dhe për t'u ankuar". Gjithashtu, bashkëlidhur formatit të kërkesës të vendosni mjetin e identifikimit (kartë identiteti), për të vijuar me trajtimin e kërkesës suaj.	E plotë	Nuk ka
47	29.09.2026	Urgjente-Përcjellje elektronike e Peticionit publik për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore…..	30.09.2026	Në lidhje me kërkesën Tuaj, për regjistrimin dhe protokollimin e komunikimit, ju njoftojmë se për protokollimin e kërkesës duhet që kërkesa të përcillet me postë zyrtare.	E plotë	Nuk ka
48	30.09.2026	Kërkesë	06.10.2026	Në përgjigje të shkresës suaj…..Ju bëjmë me dije se: AZHT ushtron funksionin e Sekretariatit Teknik të KKTU dhe,në përputhje me VKM-në nr.725,datë 02.09.2015 'Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT',të ndryshuar,ka në kompetencë pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, i cili i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga KKTU. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë AZHT-së,si dhe i dokumentacionit të paraqitur bashkëlidhur kërkesës suaj, rezulton se prona objekt zhvillimi, pozicionohet në një zonë për të cilën nuk rezulton të jetë miratuar Vendim i Këshillit të Ministrave për shpalljen e saj si "Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore". Ju lutemi, për të vijuar me procedurat për përfshirjen në zonat me ekonomi malore dhe për përfitim nga masat e parashikuara në kuadër të "Paketës së Maleve",të drejtoheni pranë bashkisë....,duke paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm,për verifikimin e situatës së pronës dhe të mundësisë së përfshirjes së saj në një zonë të shapallur sipas parashikimeve të Ligjit 20/2025. Né zbatim te Nenit 5, te Ligiit Nr. 20/2025, Pas shpalljes së zonës së zhvillimit, subjekteve (persona fizikë, juridike apo individe), që zotërojnë pa titull pronësie pasuri shtetërore brenda kësaj zone, u lind e drejta te njihen si "posedues jopronare", me Vendimin e Keshillit Bashkiak përkatës. Gjithashtu sipas Nenit 6 te Ligiit Nr. 20/2025, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, që shpall zonën e zhvillimit duhet të paraqisni pranë Bashkisë .... kërkesën për njohjen si "posedues jopronar" e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë vijon: ..... AZHT shpreh angazhimin maksimal për t'ju asistuar për çdo informacion shtesë që mund të jetë i nevojshëm për trajtimin e çështjes. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

49	30.09.2026	Kërkesë për informacion në lidhje sa vendosur për…...	06.10.2026	Në përgjigje të kërkesës Suaj për informacion mbërritur nëpërmjet postës elektronike, ju bëjmë me dije se: ..... KKTU në mbledhjen .... ka miratuar me kusht Vendimin ....., vendimarrje e cila nuk është zbardhur ende e për rrjedhojë nuk është lëshuar as dokumenti i lejes së ndërtimit. Në vijim të kërkesave për dokumentacion në lidhje me aplikimin sipërcituar, ju bëjmë me dije se AZHT5 nuk mund t'ju vendosi në dispozicion dokumentacionin teknik të kërkuar nga ana juaj, pasi referuar Nenit 17 "Kufizime", pika 1, shkronja "c", të Ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", citohet se e drejta për informim kufizohet kur dëmton të drejtën e autorit. Mbështetur në Nenin 8 "Veprat", pika 1, shkronjat "e" dhe "g", të Ligjit Nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë: e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore. g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi; Për sa më sipër, ju informojmë se pas përfundimit të gjithë porcedurave administrative nga AZHT si dhe plotësimit të kushteve nga subjekti zhvillues do të vijohet me lëshimin e dokumentit të lejes së ndërtimit i cili më pas do të publikohet në faqen zyrtare të AZHT: http://www.azht.gov.al, në rubrikën "Vendime KKTU".	E plotë	Nuk ka

50	30.09.2026	Kërkesë për konfirmim mbi përfshirjen e pasurisë ….....	30.09.2026	Në përgjigje të kërkesës Suaj, ..., Ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon: AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU, në mbështetje të Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015 *"Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT"* , i ndryshuar, ka kompetencë *pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së* . ..... Në lidhje me vendimarrjen e sipërcituar ju bëjmë me dije se, vetëm pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit teknik-ligjor nga ana e subjektit zhvillues, institucioni jonë do të vijojë me procedurat e zbardhjes së vendimimit të sipërcituar, të cilët pas nënshkrimit nga Kryetari i KKTU-së, Ministrit të Linjës si dhe Sekretari i KKTU-së, do të mund t'i aksesoni në faqen zyrtare web të AZHT www.azht.gov.al, në rubrikën "Vendime KKT". Theksojmë se, për vendimmarrjet të cilat nuk janë zbardhur ende, përfshirë hartat e planvendosjes së strukturave mund t'ju vendosen në dispozicion vetëm pas zbardhjes së vendimit. Sqarojmë se, në referim të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative, akti administrativ duhet të respektojë disa kërkesa të formës, si dhe në zbatim të nenit 100 të po këtij Kodi, akti administrativ i shkruar duhet të jetë i arsyetuar qartë, duke përmbajtur situatën faktike, si edhe bazën ligjore mbi të cilën mbështetet. Për sa kohë akti nuk është zbardhur dhe nuk përmban ende këto elemente thelbësore të formës dhe arsyetimit, ai nuk mund të konsiderohet një akt administrativ i formuar ligjërisht, i cili të mund t'iu vendoset në dispozicion. Në lidhje me pasuritë objekt zhvillimi, ju konfirmojmë se sikurse paraqitet edhe në poligonet e vendosura në dispozicion ashtu edhe nga verifikimi... pasuria juaj ...., nuk është pjesë e zhvillimit e për rrjedhojë nuk preket nga asnjë nga aplikimeve sipërcituar. Me vendimimet e lartpërmendura, KKTU ka miratuar kushtet zhvillimore për pronën/pronat mbi të cilat do të zhvillohet projekt-propozimi, referuar Nenit 3, pika 17, të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, që përcakton shprehimisht se: *"Leje zhvillimi" është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi."* *Gjithashtu sqarojmë se, Leja e Zhvillimit është një dokument në të cilën përcaktohen vetëm kushtet e zhvillimit për një parcelë/pronë të caktuar, konkretisht përdorimi i tokës, intensiteti i ndërtimit, koeficenti i shfrytëzimit të tokës, distancat etj., dhe nuk nënkupton që në bazë të këtij dokumenti subjekti zhvillues mund të filloj punimet për ndërtim.* Për sa i përket distancave nga kufitarët, ju sqarojmë se referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në Nenin Nr. 28,"Përgjegjësitë e KKTU", pika 3, përcaktohet se: "KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj". Për sa më sipër, referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në Nenin Nr. 28,"Përgjegjësitë e KKTU", pika 3, përcaktohet se:"KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj".	E plotë	Nuk ka